



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:223021

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625676

**A.nr.2306/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit L.RR., nga fshati ..., Komuna e ..., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Mirëqenies Sociale, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës se paditur, me datë 22.04.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit ..., nga fshati .... Komuna e ... me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi numër 2280 i datës 01.09.2021 dhe të detyrohet e paditura ti vazhdohet ndihma sociale edhe për vitin 2022 dhe vitin 2023 në shumën e caktuar për ndihmën sociale apo lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 05.10.2021, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet kërkespadia e tij dhe të anulohet vendimi Nr. 2280 i datës 01.09.2021, i Ministrisë së Punë dhe Mirëqenies Sociale. Paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë së parashtruar në gjykatë me të cilën ka kërkuar që vendimi me numër 2280 i datës 01.09.2021. Për rreth 6 muaj kam qenë përfitues i ndihmës sociale pastaj kam qenë i vendosur në shtëpinë e axhës dhe pas 6 muajve është ndaluar ndihma sociale, me arsyetimin se unë e kam një vëlla i cili jeton në Zvicër. Me dokument sic është deklarata e bashkësisë familjare e kam dëshmuar e unë jetoj vetëm me familjen time të ngusht bashkshorten djalin dhe një vajzë të vogël 4 muajshe. Dhe që nga ajo kohë e deri më tani jam i pa punë. Është e vërtetë se vëllau ka jetuar në Zvicër dhe jeton i ndarë dhe secili jetojmë të ndarë në shtëpitë tona. Andaj vendimi mbi refuzimin e ankesës është i pa drejtë dhe nuk kanë paraqitur gjendje reale ashtu siç është më të vërtetë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë deklarimeve të thënë në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që padin ta aprovon në tërësi sit ë bazuar dhe të anulohet vendimi numër 2280, i datës 01.09.2021 dhe të më nihet e drejta nga e paditura edhe për 6 muaj për vitin 2021 socialia dhe të më vazhdohet ndihma sociale edhe për vitet 2022, 2023, në shumën e cila është e përcaktuar për ndihmë sociale.

E paditura në përgjigje në padi të datës 14.08.2023 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ku Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhmës Sociale Shkalla e II-të/ Departamenti për Politika Sociale dhe Familjes ka nxjerr Aktvendimin numër 2280 pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe faktet relevante dhe ka konstatuar se familja nuk i plotëson kriteret për ndihmë sociale, sipas verifikimit nga komisioni verifikues i QPS-së, pasi që familja nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara nga komisioni rreth bashkësisë familjare dhe gjendjen ekonomike familjare.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, bëri administrimin e provave dhe atë: Vendim A.nr.3/21/23, i dt. 29.09.2021, nga Agjencia për ndihmë juridike, Kopja e lejes së njoftimit dt. 30.07.2018, në emër të ..., Aktvendim i dt.01.09.2021, nga MFPT, Vërtetim i papunësisë i dt.05.07.2021, i lëshuara nga MPMS: Vërtetim i papunësisë, i dt.01.10.2021, Kontratë mbi Dhënien e shtëpisë në shfrytëzim pa kompensim, dt. 31.01.2021, Kontratë mbi shkëputen e bashkësisë familjare, dt. 15.02.2021, Kartela e Ndhmës Sociale kategoria 2-të, dt.05.03.2021, nr.40890, Deklaratë e Bashkësisë familjare nr. F 11119862, e dt.28.09.2021, në emër të ..., Sqarim për përgjigje në padi, dt.17.07.2023, Përgjigje në padi dhe shkresat e lëndës së ..., nga Podujeva, dt. 12.07.2023, i lëshuar nga Departamenti dhe politika sociale, Të dhënat e Parashtruesit të kërkesës-Shfrytëzuesit të ndihmës sociale, për ..., Ankesa e parashtruar nga paditësi, dt.17.08.2021, Faturë e KES/CO e dt. 12/2020, në emër të ..., Transaksionet e konsumatorit, dt. 05.07.2021, në emër të ..., Ankesa e paditësit e dt.11.08.2021, Aktvendim Nr. Lëndës 40819, i dt.19.07.2021, nga MPMS, Dëftesë mbi parashtrësën e kërkesës për ndihmë sociale D-1, dt.06.07.2021, Dërftesa e paraqitjes për ndihmë sociale, në emër të paditësit, Formular për përllogaritjen e të mirave materiale dhe jo-materiale, si dhe të hyrave të llogaritshme dhe jo-llogaritshme, dt. 19.07.2021, Certifikatë e Bashkësisë Familjare e dt.04.07.2017, në emër të ..., Certifikatë Nr.04 916/20, i dt.07.12.2020, Certifikatë që nuk posedon pronë të paluajtshme, dt. 07.12.2020, Nr.Prot; 08-942/06- 0074271/20, në emër të ..., Certifikatë që nuk posedon pronë të paluajtshme, dt. 07.12.2020, Nr.Prot; 08-942/06-0074271/20, në emër të ..., Kopje e lejes së njoftimit dt.28.08.2017, e ..., Certifikatë e martesës 07.07.2017, Certifikatë e lindjes e dt.22.05.2017, nr.ser. L 21503351, për ..., Kopja e lejes së njoftimit të dt.22.03.2017, në emër të ..., Deklarata nën betim, nr.rend .LRP 20/2021, dt.05.01.2021, në emër të ..., Certifikata që nuk posedon pronë të paluajtshme dt.15.09.2021, Aktvendim Nr. i Lëndës 40819, i dt. 22.02.2021, nga Departamenti ndihmë sociale, Formular për përllogaritjen e të mirave materiale dhe jo materiale, si dhe të hyrave të llogaritshme dhe jo-llogaritshme, A-3, dt.19.02.2021

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKAsë dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me vendimin e kontestuar me numër 2280, të datës 01.09.2021, gjykata vërtetoi se e paditura, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit se ndihma sociale është ndërprerë familjes në mungesë të dëshmisë që vërteton se jeton në adresën e paraqitur dhe dëshmi rreth bashkësisë familjare dhe gjendjes ekonomike të familjes.

Me Aktvendimin nr.40819, të datës 19.07.2021, gjykata vërtetoi se paditësit i është kërkesa për ndihmës sociale familjes së ..., me arsyetimin se komisioni i QPS-së ka bërë verifikimin e familjes dy herë, ku hera e parë me datë 13.07.2021 dhe hera e dytë me datë 19.07.2021 dhe nuk kanë takuar askënd në adresën e dhënë nga familja dhe nuk ka paraqitur të gjitha anëtarët e familjes në kërkesën e ndihmës sociale, ku sipas të afërmëve të familjes kanë thënë se paditësi jeton me prindër dhe vëllain i cili gjendet në botën e jashtme.

Me kartelën e ndihmës sociale numër 40189, të datës 05.03.2021, në bazë të saj gjykata gjeti se paditësit e paditura ia ka njohur të drejtën e përfitimit të ndihmës sociale prej datës 01.01.2021 e deri më datë 30.06.2021, në shumën 97.50 euro.

Nga formulari për përllogaritjen e të mirave materiale A3 i përpiluar nga e paditura me datë 19.07..2021, gjykata gjeti se gjatë verifikimit të gjendjes së paditësit është konstatuar se me rastin e rivlerësimit në teren familja nuk ka prezantuar dy herë gjatë verifikimit me datën 13.07.2021 dhe datës 19.07.2021 dhe nuk ka prezantuar të gjithë anëtarët e familjes ka ndarje fiktive.

Gjykata iu referua nenit 4 të Ligjit 2003/2015, si dhe ligjit numër 04/L-096 për Ndryshmin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/215, ku përcaktohet se “*Periudha e shfrytëzimit të ndihmës sociale 7.1. Familja që ka fituar të drejtën e ndihmës sociale në përputhje me nenin 4, pika 1(a) do të marrë ndihmë sociale deri në gjashtë muaj, me kusht që t’i plotësojë kriteret e parashikuara gjatë kësaj periudhe. Pas kalimit të periudhës së lartpërmendur, familja duhet të bëjë kërkesë të re për vazhdimin e të drejtës për ndihmë sociale. 7.2. Familja që ka fituar të drejtën e ndihmës sociale në pajtim me nenin 4.1 (b) do të marrë ndihmë sociale deri në gjashtë(6) muaj, me kusht që t’i përmbushë kriteret e parashikuara gjatë kësaj periudhe dhe të ndërmarrë veprime të nevojshme për punësim, sipas kërkesës së organeve përkatëse. Organet përkatëse kërkojnë nga ata dëshmi mbi orvatjet e tyre për të gjetur punë dhe shpeshtësia e këtyre dëshmive përcaktohet në Udhëzimin të cilin e lëshon Ministria. Pas mbarimit të periudhës së përmendur më sipër, familja paraqet kërkesë të re për ndihmë*”. Gjykata ka gjetur se në bazë të provave paditësi ka vepruar konform nenit 7 të ligjit për Skemat për Ndhimë Sociale mirëpo gjatë verifikimit nga ana e Komisionit për verifikim nuk kanë mundur të vërtetohet se paditësi me familjen e tij ka jetuar në shtëpinë ku edhe ka dhënë të dhënat se jeton aty. Me UA numër 06/2013 neni 10 përcaktohet se të hyrat e përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto: 1.1. të hyrat e fituara; 1.2. të hyrat e trashëguara, dhurata; 1.3. të hyrat e pranuar në mall; 1.4. qiraja, dërgesat e parave; 1.6. pensionet e kursimeve individuale dhe pensionet plotësuese individuale ose të punëdhënësve; i .7. pensionet që merren nga jashtë; i 8. disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat paditësi as pranë të paditurës e as pranë gjykatës nuk ka argumentuar se i njëjti jeton në shtëpinë e lëshuar nga axha i tij dhe se nuk jeton në bashkësi familjare që nga viti 2021, pasi që edhe në seancën e shqyrtimit kryesore i njëjti ka theksuar se vëllai jeton në Zvicër dhe tani jeton në shtëpinë e tij i ndarë nga vëllai.

Gjykata gjeti se Vendimi përfundimtar i kontestuar nga paditësja, është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi, përkatësisht konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Sa i përket vendimit përfundimtar të marrë nga e paditura, gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditëses dhe vendimi i atakuar i përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Struktura formale e vendimit, është në përputhje të plotë me nenin 47 të LPPA-së, ashtu sikurse edhe arsyetimi i dhënë, përputhet në tërësi me nenin 48 të po të njëjtit Ligj.

Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësi as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ofroi prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e tij të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës, i është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar me ligj.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar me refuzimin e kërkesës për ndihma sociale për mungesë të argumenteve dhe paraqitjes së gjendjes reale të kushteve të vendbanimit dhe bashkësisë familjare të tij.

Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës pasi që edhe vet pala paditëse me provat e ofruara nuk kanë qenë bindëse, andaj gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësit.

Mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës, u morë duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 43, 46, par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.2306/2021, të datës 22.04.2024.**

**Sekretare juridike**

**Nazife Sheholli**

**G j y q t a r j a**

**Valbona Gjonbalaj**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.